

VENDIM
Nr. 50, datë 1.10.2014

**PLANI I NDIHMËS SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E FONDIT NË MBËSHTETJE
TË SIPËRMARRJEVE TË REJA “START-UP””**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesë-marrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtare
Edmond Ademi	anëtar

Ahmet Maçellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtare,

në mbledhjen e tij të datës 1.10.2014, shqyrtoi raportin për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up””. Njoftimi i skemës është bërë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me shkresën nr. 4808/4, datë 9.7.2014 dhe është regjistruar në regjistrin me nr. Al/N/16/2014.

OBJEKTIVI I SKEMËS SË NDIHMËS: Skema synon të nxisë krijimin dhe konsolidimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

BAZA LIGJORE E SKEMËS: Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up””, i iniciuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të regjistruara pranë QKR-së, për një periudhë nga 1 deri në 2 vjet.

2. Ndihma do të jepet ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në sektorët prodhues dhe të shërbimit, sektorin e industrisë së lehtë, sektorin e turizmit, fushën e kërkimit dhe të zhvillimit, në procesin e agropërpunimit dhe në fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.

3. Ndihma do të jepet në formën e grantit. Shuma gjithsej e ndihmës është 25 000 000 lekë. Ndihma për një ndërmarrje do të jepet për mbulimin e 70 % të kostove të pranuar, por nuk do të kalojë shumën 300 000 lekë.

4. Kosto të pranueshme janë:

- investime në pajisje dhe teknologji për nxitjen e prodhimit/shërbimit;
- marketingu i produktit dhe promovimi;
- kualifikimi dhe trajnimi për rritjen e aftësive sipërmarrëse;
- krijim faqe interneti, publikime materiale promovuese;
- pjesëmarrje në një panair ose ekspozitë brenda apo jashtë shtetit, si vizitor apo ekspozues.

5. Skema e njoftuar do të fillojë të zbatohet në vitin 2014, dhe do të zgjasë 4 vite.

6. Dhënës i ndihmës është Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj mase do të jetë Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

7. Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema e njoftuar përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- Ndihma jepet nga autoritete publike, përmes burimeve shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 9374 datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

- Skema ndikon në uljen e shpenzimeve për krijimin e ndërmarrjeve në vend, duke i dhënë një avantazh, i cili mund të ndikojë ose të kërcënojë të dëmtojë konkurrencën.

- Skema është selektive, sepse ndihma jepet për një numër të kufizuar ndërmarrjesh.

- Skema lidhet me sektorë dhe ndërmarrje, të cilët janë të përfshirë në tregtinë me shtetet e rajonit, dhe mund të ndikojë në tregtinë ndërshtetesh.

8. Skema e njoftuar është në përputhje me nenin 9/1 “Ndihma për ndërmarrjet e vogla, të sapokrijuara” të ligjit të ndihmës shtetërore, shkronja “a”, ku vlera e ndihmës nuk e kalon masën 200 000 euro dhe shkronjën “b” ku vlera vjetore nuk duhet të kalojë 33 për qind të vlerës së ndihmës së parashikuar në shkronjën “a”.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 9/1, 13, pika 3, 22, pika 2, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e njoftuar të ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up””.

2. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

3. Të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ahmetaj